



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI**

---

Nr. 952/8 Prot.

Tiranë, më 31/03/2016

### **V E N D I M**

**Nr. 30, Datë 31/03/2016**

**PËR  
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË  
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT  
“MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË  
AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR DHE VLERËSIMIN E  
FUNKSIONEVE TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe mendimet nga kontrolli i cilësisë pas procedurës së ndjekur për rishikimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësoj që veprimtaria menaxheriale institucionale gjatë vitit 2015 është e orientuar drejt përmbushjes së objektivave strategjike për përafrimin e kuadrit rregullator ligjor e metodologjik të KLSH-së, me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik dhe prioritetet drejt integritetit evropian. Gjithashtu pozitivisht vlerësohet edhe përgjegjshmëria menaxheriale e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit gjatë ekzekutimit të fondeve buxhetore në funksion të modernizimit institucional.

Bazuar në nenet 10 dhe 15 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014”Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

### **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar dhe vlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar”.

**II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon**

**A. MASAT ORGANIZATIVE**

**Gjetje nr. 1:** Nga auditimi i 7 tenderëve të realizuar gjatë vitit 2015, me procedurë “Kërkesë për propozim” (Blerje Karburanti për vitin 2015 për KLSH; Shërbime për Automjete KLSH; Blerje bojë dhe pajisje kompjuterike; Blerje bojë printeri dhe fotokopje; Blerje Botim Libra; Menaxhim i qendëruar të sigurisë të rrjetit të KLSH, 2015; Rinovim i Suportit të Platformës Idea të KLSH 2015), rezultoi se në dosjet, mungon procesverbali i përzgjedhjes së Operatorëve Ekonomikë që ftohen për të marrë pjesë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 34, pika 1 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, nenin 39 “Kërkesa për propozime”, pika 4.

**Rekomandim nr. 1:** Në rastet e kryerjes së tenderëve me procedurë “Kërkesë për propozim”, ku Autoriteti Kontraktor fton për të marrë pjesë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, në çdo rast Njësia e Prokurimit duhet të miratojë me procesverbal përzgjedhjen e pesë Operatorëve Ekonomikë që do të ftohen për të marrë pjesë në tender, duke dhënë dhe argumentimin për përzgjedhjen e tyre.

**Vazhdimisht**

**Gjetje nr. 2:** Në të gjitha procedurat e prokurimit elektronik të blerjeve me vlera të vogla të materialeve dhe mallrave, të prokurimit elektronik të blerjeve me vlera të vogla të biletave të avionëve dhe në 7 tenderët e realizuar me procedurë “Kërkesë për propozim”, (Blerje Karburanti për vitin 2015 për KLSH; Shërbime për Automjete KLSH; Blerje bojë dhe pajisje kompjuterike; Blerje bojë printeri dhe fotokopje; Blerje Botim Libra; Menaxhim i qendëruar të sigurisë të rrjetit të KLSH, 2015; Rinovim i Suportit të Platformës Idea të KLSH 2015), rezultoi se në dosjet përkatëse mungon Formulari i Deklarimit të Konfliktit të Interesave të anëtarëve të Njesisë për Testimin e Tregut dhe përcaktimin e fondit limit; të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me vlera të vogla, të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit si dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, veprim ky në kundërshtim me:

- nenet 56 dhe 64, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

- nenit 4 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;

- nenin 4, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;

- nenit 46, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

- nenit 12-Parandalimi i konfliktit të interesave të Pjesës së Pestë, të Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 53, datë 16.04.2012, si dhe

- nenit 17, të Kreut IV-Parandalimi i konfliktit të interesave, të Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Funkcionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015.

**Rekomandim nr. 2:** Të gjithë punonjësit që marrin pjesë në procedurat e blerjeve me vlera të vogla dhe tenderët si: anëtarët e Njesisë për testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit; anëtarët e Komisionit të Prokurimit me vlera të vogla, anëtarët e Njesisë së Prokurimit si dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duhet të hartojnë Formularin e Deklarimit të Konfliktit të Interesave, e cila do të jetë pjesë e dosjes.

**Gjetje nr 3.** Në të gjitha rastet e prokurimeve me vlerë të vogël për blerjen e biletave të avionëve janë realizuar duke përcaktuar destinacionin nisje-mbërritje-kthim, numrin e biletave, datën e nisjes, datën e kthimit dhe në asnjë rast itinerari. Në specifikimet teknike të bëra nga Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhëniet me Jashtë, për të gjitha linjat është përcaktuar standard kërkesa që udhëtimi të jetë me një transit, pa përcaktuar kohën faktike të qëndrimit në transit, Kjo kërkesë është përcaktuar njëkohësisht edhe për linjat direkte.

**Rekomandim nr. 3:** Njësia e Prokurimit në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit mbi bazën e përdorimit të standardeve teknike ndërkombëtare të analizojë dhe miratojë specifikimet teknike si më poshtë:

*a. Termat e referencës*

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve

KLSH kërkon të lidhë një marrëveshje kuadër, me afat 1 ose 2 vjeçar, me disa/ose me një operatorë ekonomikë me fondin limit të vendosur në këto dokumente, të përlllogaritur për blerje biletash udhëtimi për periudhën kohore 1 ose 2 vjeçare, me agjenci turistike ose shoqëri fluturimi për prerjen e biletave të udhëtimit për nevojat e saj.

Autoriteti Kontraktor në çdo rast do të prokurojë bileta udhëtimi sipas nevojave të tij dhe nuk është i detyruar në asnjë mënyrë të ezaurojë të gjithë fondin limit të sipërpërmendur.

*b. Përgjegjësitë që duhet të përmbushë Autoriteti Kontraktor në kuadër të shërbimeve të kërkuara.*

Autoriteti Kontraktor përfitues i shërbimeve të kërkuara angazhohet të:

Dërgojë tek Operatori/Operatorët Ekonomikë të përzgjedhur, palë e marrëveshjes kuadër “Ftesën për Ofertë” për biletat e udhëtimit kurdo që paraqitet nevoja për to.

Likuidojë në kohë shërbimet e përfituara sipas kontratës së marrëveshjes kuadër por çdo faturë tatimore shitje (biletat e avionëve) duhet të shoqërohen me vërtetim mbi vlerën e derdhur në llogari të IATA International Air Transport Association me anë të Faturimit të shlyerjes së të ardhurave prej pasagjerëve nga agjentët e udhëtimeve tek shoqëritë e fluturimit (IATA Billing and Settlement Plan (BSP Link), transaksion i cili kryhet nga çdo agjenci udhëtimesh në mënyrë periodike mbi bazën e biletave të shitura.

*c. Kriteria të tjera specifike të veçanta*

- Operatori/Operatorët ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë akreditimi lëshuar nga International Air Transport Association (IATA), të vlefshme për vitin 2016. Për këtë kërkesë operatori/operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatën origjinale ose kopjen e noterizuar lëshuar nga International Air Transport Association (IATA).

Operatori/Operatorët ekonomik duhet të jetë detyrimisht përdorues i programit Amadeus, Sabre dhe Galileo, kjo kërkesë duhet të vërtetohet me anë të një vërtetimi lëshuar nga zyrat e përfaqësuese të prodhuesve të këtyre programeve për operatorin ekonomik.

## Menjëherë

**Gjetje nr. 4:** Në tenderin e zhvilluar me objekt : “Menaxhim i qendëruar të sigurisë të rrjetit të KLSH 2015” dhe në tenderin e zhvilluar me objekt : “Rinovim i Suportit të platformës Idea të KLSH 2015”, grupi i punës që ka hartuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit dhe Njësia e Prokurimit që ka miratuar këto kritere në pikën: “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” nuk ka paraqitur kërkesa, konform përcaktimeve të dhe kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

**Rekomandim nr. 4:** Në blerjen e mallrave dhe materiale me procedurë “Kërkesë për propozim”, nga Grupi i Punës që do të hartojë dokumentet e tenderit të përcaktojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose

#### **Vazhdimisht**

**Gjetje nr.5:** Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator referuar prokurimit të fondeve me objekt “Blerje bileta avioni për linja ndërkombëtare” nëpërmjet procedimit me marrëveshje kuadër rezulton se sikurse është përcaktuar në VKM dhe Udhëzimin përkatës ekziston risku i shmangies së konkurrencës, dhe lidhjes së marrëveshjeve të fshehta midis operatorëve ekonomikë me të cilët është lidhur marrëveshja, pasi procedurat e mëtejshme vazhdojnë nëpërmjet ofertimit manual dhe pjesëmarrja e operatoreve në kushtet e tregut shqiptar është mjaft e kufizuar.

Ekzistenca e riskut potencial të marrëveshjeve të fshehta midis operatoreve ekonomike tashmë të kontraktuar nga marrëveshja kuadër, çon në rritjen e shpenzimeve të konsiderueshme të çmimeve të biletave të transportit me linja ndërkombëtare si dhe cenon parimet bazë të prokurimit publik që është menaxhimi i fondeve me efikasitet dhe efektivitet.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 13-Agjencia e Prokurimit Publik, përcakton shprehimisht:

b) nxit dhe organizon kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

d) në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi;

dh) paraqet një raport vjetor në Këshillin e Ministrave për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik;

f) nxit dhe mbështet **përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare** për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve.

Mbështetur në përgjegjësitë e mësipërme që i ka bërë LPP, kompetencave kryesore të APP-së, rezulton se ky organ rregullator që harton politika, në drejtim të blerjes së biletave të avionëve, nuk ka hartuar asnjë udhëzim të detajuar dhe konkret referuar procedurave të prokurimit të këtyre fondeve.

**Rekomandim nr. 5:** Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa për përmirësimin e kuadrit rregullator nënligjor referuar treguesit të performancës së Autoritetit Kontraktor gjatë fazës së përlllogaritjes së fondit limit, kriterëve të vlerësimit, kushteve të kontratës, kushteve të marrëveshjes kuadër etj., si dhe të orientojë AK për përdorimin e regjistrit të riskut që të maksimalizojë përdorimin eficient dhe efikas të LPP-së. Udhëzimi nr. 6, datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”, është në terma të përgjithshëm, dhe nevojitet të plotësohet apo të amendohet me raste konkrete objekt prokurimi apo nëpërmjet përdorimit të udhëzimeve bazuar në problematikat e hasura nga APP gjatë proceseve të saj të monitorimit.

Nga APP të monitorohet procesi dhe të analizohet problematika në mënyrë transparente, dhe gjithë përfshirëse për të evidentuar problematikat e procesit jo duke shigjetuar përdoruesit (prokuruesit) por duke identifikuar pikat e dobëta të sistemit që kanë nevojë për përmirësim, me synim efikasitetin dhe efikasitetin e sistemit të prokurimit (sistemi ligjor). Të orientoohen autoritetet

kontraktore të hartojnë më parë një regjistër risku, ndarje përgjegjësish, role e detyra, procedura standarde apo specifikimet teknike një problem ky i vështirë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, në drejtim të përdorimit të standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare për biletat e avionëve, për vetë specifikën e veçantë që kanë dhe realisht është një industri e fshehtë në vendin tonë.

**Menjëherë**

**Rekomandim nr 6 :** Marrë shkas nga konstatimi se çmimet e biletave të avionëve janë më të ulëta kur blerja e tyre kryhet në një periudhë më të hershme dhe në funksion të menaxhimit me efektivitet të fondeve buxhetore rekomandojmë që kërkesa për blerjen e biletave të avionëve nga Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënive me Jashtë, të kryhet 2-3 javë para nisjes së grupeve të punës.

**Menjëherë dhe Vazhdimisht**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në KLSH.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**